

KONTRATE E PERGJITHESHME

PER KRIJIMIN E ORTAKERISE "EUROKOL" - TIRANE

Midis ortakeve:

- Petrit Mersini, lindur ne Gjirokaster me 6.1.1930 dhe banues ne Rr.Vellezerit Manastiri P.11 Sh.2 Ap.29 Tirane,
- Natasha Moisiu, lindur ne 21.11.1946 dhe banuese ne Rr.Barikadave P.8 Ap.41 Tirane,
- Pandi Carapuli, lindur ne Tirane me 23.7.1953 dhe banues ne Rr.Luigj Gurakuqi P.15/1 Sh.7 Ap.56 Tirane,
- Robert Kasneci, lindur ne Tirane me 12.12.1953 dhe banues ne Rr.Konferenca e Pezes, P.3 Sh.6 Ap.59 Tirane,
- Luan Shahu, lindur ne Gjirokaster 21.6.1931 dhe banues ne Rr.Punetoret e Rilindjes P.1 Sh.2 Ap.43 Tirane.

Si ortake te barabarte ne firmen EUROKOL me seli ne Rr.Vellezerit Manastiri P.11 Sh.2 Ap.29 Tirane.

NENI 1

Personat fizike te siperpermendur u moren vesh te formojne nje ortakeri me aktivitet e seli ne Tirane, e cila do te quhet EUROKOL.

Firma mund te krijojte dege ose filiale brenda e jashte vendit, te cilet do te kryejne veprimtarine e tyre per llogari dhe ne emer te saj.

Firma dhe filialet e saj do te zhvillojne veprimtarine e parashikuar nga kjo kontrate dhe statut i saj.

NENI 2

Kjo firme ka per objekt tregtine e mallrave te ndryshme ushqimore, industriale brenda e jashte vendit, transportin e mallrave me brenda e jashte dhe sipas rastit dhe mundesive qe do te krijohen do te merret edhe me investime direkte dhe indirekte ne fushen e prodhimit e te sherbimeve.

NENI 3

Kapitali fillestar i firmes do te jete 100.000,- leke (njqindmije) me pjesemarrjen e barabarte te te gjithe ortakeve.

NENI 4

Firma do te drejtohet sipas rregullave te percaktuara ne statut. Organi me i larte eshte Keshilli i Ortakeve i perbere nga pese ortaket. Drejtori i Pergjithshem dhe zevendesi i tij zgjidhen nga Keshilli i Ortakeve cdo vit, po keshtu emerohet edhe i gjithe personeli tjeter i administrates nepermjet kontrtates se punes te rinovueshme cdo vit.

NENI 5

Afati i veprimtarise se firmes eshte 31.12.2000, por ajo mund te zgjatet ose nderprese veprimtarine e saj para ketij afati sipas rregullave te percaktuara ne statuin e saj.

Firma nuk mund te shperndahen ne rast se te pakten dy nga ortaket nuk e desherojne ate.

NENI 6

Ne qoftese gjate aktivitetit te firmes, njera nga palet heq dore per aresye te ndryshme ose vdes, te drejttat dhe detyrimet e tij parashikohen sipas statutit dhe me vendime te Keshillit te ortakeve. Ortaku qe heq dore mund t'ia shese pjesen e tij te qendrueshme nje personi tjeter jashte ortakerise vetem kur nuk blihet nga ortaket e tjere te firmes.

NENI 7

Per cdo vendim te rendesishem ekonomik financiar qe do te merret gjate veprimtarise se firmes nevojitet detyrimisht mendimi (vendimi) i Keshillit te Ortakeve.

NENI 8

Viti fiskal eshte 1 Janar deri 31 Dhjetor te cdo viti. Ne mbarim te cdo viti fiskal, me mbylljen e librave te llogarise, fitimet o humbjet e ortakeve qe do rezultojne do te ndahen proporcionalisht, d.m.th. nga 20% per sejcilin ortak.

NENI 9

Cdo mosmareveshje qe mund te linde gjate zbatimit te kesaj mareveshje, do te zgjidhet ne rrugen e mirekuptimit. Ne rast se nuk arrihet kjo, atehere ceshtja do t'i referohet per gjykim Gjykates se Rrethit te Tiranes.

NENI 10

Kjo mareveshje mund te ndryshohet ose te plotesohet me propozimin me shkrim te cdo ortaku dhe me miratimin e ketij propozimi nga Keshilli i Ortakeve me vendim unanim te tij.

Mareveshja hyn ne fuqi me miratimin e firmes EUROKOL ne Gjykatën e Rrethit te Tiranes.

Bere e nenshkruar ne Tirane me 14.11.1991.

Petrit Mersini

Natasha Mdisiu

Luan Shabani

Pandi Carapuli

Robert Kasneci

K O N T R A T E

9

Per krijimin e shoqerise "EUROKOL" SHPK.

Sot me daten _____, ditën e _____ ndërmjet :

- 1) Petrit Mersini, lindur ne Gjirokaster me 6.1.1930 dhe banues ne Rr.Vellezerit Manastiri P.11 Sh.2 Ap.29 Tirane,
- 2) Natasha Moisiu, lindur ne Shkoder me 23.11.1946 dhe banuese ne Rr.Barikadave P.8 Ap.41 Tirane,
- 3) Pandi Carapuli, lindur ne Tirane me 23.7.1953 dhe banues ne Rr.Luigj Gurakuqi P.15/1 Sh.7 Ap.56 Tirane,
- 4) Robert Kasneci, lindur ne Tirane me 12.12.1953 dhe banues ne Rr.Konferenca e Pezes, P.3 Sh.6 Ap.59 Tirane,
- 5) Luan Shahu, lindur ne Gjirokaster 21.6.1931 dhe banues ne Rr.Punetoret e Rilindjes P.2 Sh.3 Ap.43 Tirane.

lidhet kjo kontrate me kushtet si me poshte:

N e n i 1

Personat fizike te siperpermendur, me vullnetin e tyre te lire dhe ne pajtim me legjislacionin shqiptar, rane dakort qe te krijojne shoqerine me pergjegjesi te kufizuar me ementimin "EUROKOL" SHPK.

Kjo dhoqeri e ka qendren ne Tirane RR.BARRTKADAVE KULLIA NR.2

Ortaket te kesaj shoqerise dhe pronaret te pasurise se saj jane:

- 1) Petrit Mersini, 2) Natasha Moisiu, 3) Pandi Carapuli, 4) Robert Kasneci, 5) Luan Shahu.

Administrator i kesaj shoqerise eshte 2.Petrit Mersini dhe Natasha Moisiu

Shoqeria "EUROKOL" ka te drejte te krijojte filiale te saj brenda dhe jashte vendit ne cdo kohe qe do te cmohet e arresyeshme prej saj dhe me aprovim te organeve kompetente.

N e n i 2

Shoqeria gazon statusin e personit juridik. Veprimtaria e saj do te zhvillohet sipas dispozitave te kesaj kontrate, statutit te saj dhe legjislacionit ne fuqi. Statuti i shoqerise i bashkengjitet kesaj kontrate dhe eshte pjese perberese e saj.

N e n i 3

Veprimtaria e shoqerise si person juridik fillon me aprovimin e krijimit te saj nga organet kompetente te shtetit dhe do te vazhdoje per nje periudhe kohe prej 20 vjetesh.

Shoqeria e mbaron aktivitetin e saj me kalimin e afatit te parashikuar ne kete kontrate, neqoftese ortaket me vullnetin e tyre te lire nuk e zgjasin kete afat.

Shoqeria e mbyll aktivitetin e saj edhe para afatit te parashikuar ne paragrafin e pare te ketij neni, neqoftese per kete marrim vendim unanimitet te gjithe ortaket qe bejne pjese ne kete shoqeri.

N e n i 4

Shoqeria do te kete si objekt: Import-Eksport te te gjitha mallrave: industriale, ushqimore, bujqesore, blegtorale, grumbullimin e eksportimin e bimeve mjekesore dhe aromatike, transport brenda e jashte vendit, komisioner, tregtimin e mallrave te me siperme me pakice e shumice, ndertime, investime direkte e indirekte ne prodhim e sherbim.

11

Shoqëria është pronare, përdoruese dhe disponuese e pasurive të saj, në përputhje me qëllimin dhe objektin e veprimtarisë së saj. Shoqëria mund të blejë dhe të shfrytëzojë të drejta të tjera materiale, përfshirë të drejtën për të ofruar pasuritë e saj dhe për të marrë kredi bankare.

N e n i 5

Kapitali themeltar i kësaj shoqërie është 5.000.000 lëka.

Në krijimin e këtij kapitali ortakët do të marrin pjesë me kontribut të barabartë.

Kapitali i shoqërisë depozitohet në llogarinë e shoqërisë.

N e n i 6

Fitimi neto që do të realizohet nga veprimtaria e kësaj shoqërie do të ndahet ndërmjet ortakëve në proporcion me kapitalin e tyre në këtë shoqëri.

N e n i 7

Për detyrimet që do të krijohen ndaj personave të tretë gjatë aktivitetit të kësaj shoqërie, kjo shoqëri përgjigjet vetëm me kapitalin e saj. Ortakët nuk mbajnë përgjegjësi për detyrimet e shoqërisë me pasurinë e tyre që nuk bën pjesë në kapitalin e kësaj shoqërie.

N e n i 8

Nuk mund të pranohet në këtë shoqëri si ortak një person tjetër pa pëlqimin unanimit të ortakëve.

Nuk mund të hiqet dorë nga kjo kontratë në mënyrë të njëanshme pa pëlqimin e ortakëve të tjerë.

Ortaku që dëshiron të shesë pjesën e tij në këtë shoqëri është i detyruar që ofertën e tij për shitje të bëjë ortakëve të tjerë dhe në qoftëse këta të fundit nuk pranojnë blerjen ose nuk japin përgjigje brenda 30 ditëve nga dita e bërjes së ofertes, vetëm atëherë ortaku është i lirë të disponojë pjesën e tij.

N e n i 9

Ortakët janë të detyruar të ruajnë karakterin konfidencial të aktivitetit të shoqërisë.

Ortaku që shkel detyrimin e mësipërm dhe nga kjo shkelje shoqërisë i shkaktohet një dëm, është i detyruar të shpërblejë dëmin.

N e n i 10

Marrëdhëniet e punës në shoqëri ose në filialet e saj rregullohen nëpërmjet kontratës së punës.

N e n i 11

Konfliktet që lindin ndërmjet ortakëve duhet të zgjidhen me marrëveshje ndërmjet tyre. Në qoftëse ortakët nuk marrin vesh për zgjidhjen e konflikteve me mirkuptim, kompetent për zgjidhjen e këtyre konflikteve është Gjykata e Rektit të Tiranës.

Dispozile me te hollësishme mbi organizimin e kesaj shoqërie përcaktohen ne statutin e saj.

Ortaket pasi e lexuan me vemendje kontraten e mesiperme dhe e gjeten konform vullnetit te tyre, me vullnetin e tyre te lire e firmosin kete kontrate.

O R T A K E T

Petrit Mersini,

Natasha Moisiu,

Pandi Carapulli,

Robert Kasneci,

Luan Shahu.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E DREJTËSISE
N O T E R T A
Nr. 8945 Kol
Nr. 4860 Rep

Tirane, me 18.11.1993

V E R T E T T I M

Sot me daten 18.11.1993 para meje Mimozë Stehu Notere ne qytetin e Tiranes, u paraqiten :

- 1) Petrit Mersini, lindur ne Gjirokaster me 6.1.1930 dhe banues ne Rr.Vellezerit Manastiri P.11 Sh.2 Ap.29 Tirane,Pas.FV210752
 - 2) Natasha Moisiu, lindur ne Shkoder me 21.11.1946 dhe banuese ne Rr.Barikadave P.8 Ap.41 Tirane,Pas.A7053423
 - 3) Pandi Carapulli, lindur ne Tirane me 23.7.1953 dhe banues ne Rr.Luigj Gurakuqi P.15/1 Sh.7 Ap.56 Tirane,
 - 4) Robert Kasneci, lindur ne Tirane me 12.12.1953 dhe banues ne Rr.Konferenca e Pezes, P.3 Sh.6 Ap.59 Tirane,Pas.NF490685
 - 5) Luan Shahu, lindur ne Gjirokaster 21.6.1931 dhe banues ne Rr.Punetoret e Rilindjes P.2 Sh.3 Ap.43 Tirane,Pas.FV216086
- madhore, me zotasi te plote per te vepruan, per identitetin e te cilëve u binda pasi pashe pasaportat e tyre, te cilet me vullnetin e tyre te lire firmosen kete kontrate.

N O T E R E

Mimozë Stehu
[Signature]

10

S T A T U T I

T

SHOQERIAE ME PËRGJEGJESI TE KUFIZUAR "EUROKOL" SHPK

K R E U I

DISPOZITA TE PËRGJITHESHME

N e n i 1

Shoqeria me përgjegjesi te kufizuar "EUROKOL" SHPK themelohet ne perputhje me ligjin nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare".

Kjo shoqeri krijohet nga ortakët :

- 1) Petrit Mensini, lindur ne Gjirokastr me 6.1.1930 dhe banues ne Rr.Vellezerit Manastiri P.11 Sh.3 Ap.29 Tirane,
- 2) Natasha Moisiu, lindur ne Shkoder me 21.11.1946 dhe banues ne Rr.Barikadave P.8 Ap.41 Tirane,
- 3) Pandi Carapuli, lindur ne Tirane me 23.7.1953 dhe banues ne Rr.Luigj Gurakuqi P.15/1 Sh.7 Ap.56 Tirane,
- 4) Robert Kasneci, lindur ne Tirane me 12.12.1953 dhe banues ne Rr.Konferenca e Pezes, P.3 Sh.6 Ap.59 Tirane,
- 5) Luan Shahu, lindur ne Gjirokastr 21.6.1931 dhe banues ne Rr.Punetoret e Rilindjes P.2 Sh 3 Ap.43 Tirane,

Shoqeria e ka seline e saj Rr.BARRIKADAVE KULLIA NR.2 TIRANE dhe do te njihet me emrin "EUROKOL" SHPK.

Shoqeria "EUROKOL" SHPK ka te drejte te cele filiale, dega e perfqesi ne qytete te tjera te Shqiperise e jashte saj, ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe ate te vendeve te tjera ku ato do te hapen.

Administrator i kesaj shoqerie eshte Petrit Mensini dhe Natasha Moisiu.

N e n i 2

Shoqeria e zhvillon veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin ne fuqi dhe dispozitat e parashikuara ne dokumentet e krijimit te saj (kontrates dhe ketij statuti).

Shoqeria eshte person juridik. Ajo fiton te drejten e personit juridik nga data e regjistrimit ne Gjykate.

N e n i 3

Shoqeria krijohet per te ushtruar veprimtarine e saj per nje kohezgjatje prej 28 vjetesh.

Shoqeria mund te zgjate afatin e veprimtarise se saj ose mund ta mbylle aktivitetin e saj para ketij afati, sipas dispozitave qe percaktohen ne kete statut dhe sipas kriterëve qe percaktohen nga legjislacioni ne fuqi.

N e n i 4

Shoqeria per detyrimet qe do te lindin gjate aktivitetit te saj me te tregtat, pergjigjet vetem me pasurine e saj. Ortaket e kesaj shoqerie nuk pergjigjen per detyrimet e kesaj shoqerie me pasurine e tyre qe nuk eshte futur ne kapitalin e kesaj shoqerie.

9.9/92
[Signatures]

OBJEKTY I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Shoqeria do te kete si objekt: Import-Eksport te te gjitha mallrave: industriale, ushqimore, bujqesore, blegtorale, grumbullimin e eksportimin e bimeve mjekesore dhe aromatike, transport brenda e jashte vendit, komisioner, tregtimin e mallrave te me siperme me pakice e shumice, ndertime, investime direkte e indirekte ne prodhim e sherbim.

Shoqeria eshte pronare, pendoruese dhe disponuese e pasurive te saj, ne perputhje me qellimin dhe objektin e veprimtarise se saj.

Shoqeria mund te bleje dhe te shfrytetoje te drejta te tjera materiale, perfshire te drejten per te ofruar pasurite e saj dhe per te marre kredi bankare.

K R E U I I

MARADHENIET EKONOMIKO-FINANCIARE

N e n i 6

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqerise perbehet ne te holla dhe natyre ne nje vlere prej 5.000.000 leke. (Sipas bilancit 1.1.1993).

Ky kapital themelor zoterohet nga Ortaket ne menyre te barabarte.

Kapitali themeltar ose pjese te caktuara te tij jane te transferueshme si ndermjet ortakeve ashtu edhe perkundrejt personave te trete. Transferimi i kapitalit ose pjeseve te tij ndermjet ortakeve ose ne favor te nje personi te trete behet gjithmone me miratim unanim te te gjithë ortakeve dhe me akt noterial.

Neqoftese njeri nga ortaket desheron te shese pjesen e kapitalit te tij ne natyre, duhet te respektoje te drejten e parablerjes nga ortaket e tjere.

Te gjitha veprimet e shoqerise mbi kapitalin themeltar behen me miratimin e te gjithë ortakeve. Vleresimi i kapitalit themeltar ne natyre behet nga ortaket ne nje mareshje te vecante ose nga nje ekspert kompetent i caktuar nga ortaket.

N e n i 7

Zmadhimi ose zvogelimi i kapitalit themeltar ne teresi ose vecanti, per nje ose disa ortake behet me vendim unanim te te gjithë ortakeve.

Kapitali themeltar dhe transferimet e tij mbahen ne nje regjister te vecante.

N e n i 8

Fitimi neto i realizuar nga aktiviteti i shoqerise do te ndahet ndermjet ortakeve ne proporcion me pjeset e tyre takuese ne kapitalin themelor.

N e n i 9

Veprimtaria e shoqerise realizohet ne haze te leverdive ekonomike dhe pasqyrohet ne bilancin e saj. Bilanci i aktivitetit te shoqerise duhet te perfundoje brenda muajit Mars te vitit pasardhes. Bilanci i aktivitetit financiar mund te behet nga vete ortaket ose nga eksperte te caktuar prej tyre. Por ne te gjitha rastet rezultatet e bilancit financiar duhet te behen te njohura cdo ortaku dhe gjithmone rezultati perfundimtar duhet te merret ne shqyrtim nga asamblea e ortakeve, brenda 5 muajsh nga dita e mbylljes se vitit financiar.

N e n i 10

Shoqeria krijon fondet e saj per zhvillimin e zgjerimin e aktivitetit te saj, ne perputhje me rregullat ne fuqi.
Perberja e fondeve, burimet financiare te tyre, caktohen nga asamblea e ortakëve.

N e n i 11

Shoqeria i disponon plotesisht mjeket e saj financiare.

K R E U III

TE DREJTIAI DHE DETYRAI E ORTAKËVE

N e n i 12

Ortakët kanë te drejta kryesore te cilat ushtrohen nepermjet vendimeve te marra nga Asamblea e Ortakëve:
- Te marrin pjese ne administrimin e veprimtarive ekonomiko-tregtare te shoqerise, ne perputhje me kontraten dhe statutin.
- Te kerkojne dhe tu jepen te dhena qe kane te bejne me gjendjen dhe veprimtarine e shoqerise si dhe te gjitha dokumentat e perpunuar nga shoqeria (bilanci, libra llogarie)
- Te bejne propozime dhe ti paraqesin ato me shkrim para Administratorit dhe Asamblese se shoqerise.
- Te heqin dorë nga shoqeria ne kushtet qe percaktohen ne kontrate dhe ne kete statut.

N e n i 13

Ortakët kanë keto detyra kryesore:
- Te depozitojne kuotën e tyre ose kuotën suplementare ne perputhje me kontraten dhe me vendimet e Asamblese.
- Te marrin pjese ne administrimin e shoqerise nepermjet organeve te krijuara nga ata vete.
- Te kryejne detyrimet e ngarkuara nga Asamblea ose Administratori per realizimin e detyrave te shoqerise.

K R E U IV

ORGANIZIMI DHE DREJTIMI ADMINISTRATIV I SHOQERTISE

N e n i 14

Organi me i larte vendimor i shoqerise eshte Asamblea e ortakëve. Ne Asamble marrin pjese te gjithë ortakët me te drejte vote sipas madhësis se shumave te vena ne kapitalin themelor te shoqerise.

Asamblea e ortakëve vendos per keto probleme:

- Miraton bilancin vjetor te shoqerise.
 - Vendos per shkimin, pakesimin ose transferimin e kapitalit themelor.
 - Emeron dhe shkarkon Administratorin e shoqerise.
 - Emeron dhe shkarkon punonjesit e shoqerise, cakton rrogat, shtesat, shperblimet dhe cdo shpenzim te rëndësishem.
 - Ben modifikimin ne kontrate dhe statut sipas acurive te shoqerise.
 - Vendos per mbylljen e aktivitetit te shoqerise ose shndrimin e shoqerise.
 - Unanimiteti ne vendimet e Asamblese eshte i domosdoshem per keto ceshtje; Per modifikimin e kontrates dhe statutit, per nritjen, pakimin ose transferimin e kapitalit themelor dhe per mbylljen e shoqerise.
 - Per ceshtje te tjera Asamblea vendos me shumice votash.
- Asamblea e ortakëve thirret jo me pak se nje here ne vit.

7.9.1997
M...
...

[Signatures]

STATUT

MBI VEPRIMTARINE EKONOMIKO-FINANCIARE TE ORTAKERISE

K R E U I

DISPOZITA TE PERGJITHESHME

NENI 1

Firma e ortakerise krijuar mbi bazen e kontrates se pergjitheshme quhet EUROKOL dhe eshte nje person juridik shqiptar qe fiton zotesine per te vepruar me regjistrimin ne Gjykatën e Rrethit te Tiranes.

NENI 2

Firma EUROKOL zhvillon veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe dispozitat e parashikuara ne kontrate dhe ne kete statut.

NENI 3

Kjo firme e ka seline ne Tirane por ajo mund te cele njesite e saj organizative, filiale, dege e perfaqesi ne qytete te tjera te Shqiperise dhe jashte saj. Keto njesi krijohen ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe te vendeve ku do te ngrihen.

NENI 4

Filialet e degët neper rrethe celen si njesi organizative me vehte te varura me kooperim nga firma qendrore ne Tirane. Keto njesi organizohen mbi kriteret e ortakerise ne qender duke ndare fitimin ose humbjen mbi bazen e pjesemarrjes :

- a) te barabarte midis ortakeve ne dege ose filial
- b) zakonisht 50% me 50% midis firmes nene dhe filialit ose deges. Kjo perqindje mund te ndryshoje sipas mareveshjes.

K R E U II

TE DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKEVE

NENI 5

Ortakët gezojne keto te drejta kryesore:

- Administrimin e veprimtarise se firmes, ne perputhje me kontraten dhe statutin;
- Pjesemarrjen ne te gjitha organet e firmes;
- Marrjen e te gjithë te dhenave qe kane te bejne me gjendjen ekonomike tregtare dhe veprimtarine e firmes, si dhe me te gjitha dokumentat e perpunuara nga ortakeria, si bilancet dhe llogarite ekonomike;
- Paraqitjen e propozimeve dhe shqyrtimin e tyre nga keshilli administrativ dhe organet e tjera te ortakerise;
- Te heqje dore nga ortakeria, duke i a ofruar kuoten e vet ortakeve te tjere me ndarje te barabarte.

NENI 6

Ortakët kane keto detyrime kryesore :

- Te depozitojne kuoten e pjeses se tyre dhe kuotat suplementare ne perputhje me kontraten dhe statutin;

- Te marrin pjese ne administrimin e firmes nepermjet organeve te krijuara nga ata vete;
- Ti japin firmes te dhenat e domosdoshme per perpunimin e cdo objekti te vecante lidhur me veprimtarine e saj;
- Te kryejne detyrat per realizimin e objektivave dhe te funksioneve te firmes.

NENI 7

Sejcili ortak ka te drejte te heqe dore nga firma duke i njoftuar vendimin e tij Keshillit te Ortakeve te pakten 3 muaj perpara. Heqja dore nuk e leron ortakun nga detyrimet e marra me pare ndaj firmes dhe nuk pezullon detyrimet e firmes ndaj ortakut.

Ortaku doreheqes duhet t'ia ofroje te gjitha pjesen e tij ne vleren reale qe figuron ne dokumentat e firmes pjeses tjeter te Keshillit te Ortakeve, dhe vetem kur te gjitha ortakët nuk jane dakort mund t'ia shese nje te treti me miratim te atij keshilli. Kur doreheqja behet per arsye shendetesore ose vdekje, cdo ortak do te kete caktuar pasardhesin e vet sipas dispozitave te vecanta qe ka per trazhegimi.

K R E U III

NENI 8

Veprimtaria e firmes realizohet ne baze te leverdise ekonomike dhe pasqyrohet ne bilancet e saj.

NENI 9

Per te bere te mundur zhvillimin e veprimtarise se firmes, vihet nje kapital baze prej 100.000,- (njeqind mije) leke qe perben burimin fillestar per krijimin e fondit themelor dhe te mjeteve te xhiros.

Ortakët marrin pjese ne krijimin e kapitalit baze te firmes me kuotat e tyre, qe percaktohen ne kontraten per krijimin e firmes. Menytrat dhe afatet e derdhjes se kuotave te kapitalit baze te firmes caktohen nga Keshilli i Ortakeve.

Keshilli i Ortakeve u dorezon atyre nje dokument, me te cilin vertetohet derdhja e shumave prej tyre.

NENI 10

Kur firma pushon veprimtarine e saj, pasi shlyhen detyrimet qe ka, pjesen e mbetur te kapitalit dhe te ardhurave u a ndan ortakeve ne perpjestim me kuotat respektive ne krijimin e kapitalit te firmes.

NENI 11

Firma eshte pronare e pasurive te saj dhe ka te drejten e perdorimit dhe te disponimit te kesaj pasurie, ne perputhje me qellimin dhe objektin e veprimtarise qe kryen.

Firma gezon te drejttat per mbrojtjen e pasurive te saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

NENI 12

Firma krijon fondin rezerve dhe fonde te tjera te vecanta financimi (per zhvillimin e saj, per nxitjen ekonomike, te valutes etj.)

Perberja, shuma e pergjitheshme, burimet per krijimin e fondit rezerve, perdorimi dhe rregullimi i cdo fondi te vecante caktohet nga Keshilli i Ortakeve, ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

Firma i disponon plotesisht mjetet e saj financiare.

Detyrimet qe mund te lindin gjate veprimtarise se saj, mbuloohen nga fondi rezerve dhe nga fondet e tjera, ose nga shumat suplementare qe mund

te derdhin ortakët, kur detyrimet nuk mund të mbulohen nga fondet ekzistuese.

NENI 13

E ardhura neto e firmes, pasi zbritet amortizimi i të gjitha pasurive të luajtshme e të pa luajtshme, sipas ratave të caktuara, kuotat që kanë të bëjnë me kredite për investime, pagat e shtesat mbi pagat, shpenzimet për lëndet e para apo ndihmese e energjine si dhe shpenzimet e përgjithshme të repartive e shoqërisë dhe ato për qellime të tjera prodhuese e jo prodhuese, ndahen ndërmjet ortakëve në përpjestim me fondin e pjesëmarrjes në kapitalin bazë të firmes.

NENI 14

Pasurite e firmes vlerësohen në bilancet e saj me vlera të shprehura në monedhë shqiptare dhe të huaja, në përputhje me dispozitat përkatëse të zbatueshme në Shqipëri. Nga ky rregull behen përjashtime nga Ministria e Financave.

Bilanci vjetor paraqitet brenda datës 31 Mars të vitit pasardhës. Forma e bilanceve dhe llogarive ekonomike të firmes caktohet nga Këshilli i Ortakëve të saj, duke pasur parasysh edhe formën e bilanceve e të llogarive ekonomike të vendosura për ndërmarrjet industriale, bujqësore dhe ekonomiko tregtare shqiptare.

NENI 15

Veprimtaria financiare e firmes realizohet në bazë të programeve financiare, që bëjnë pjesë në veprimtarinë ekonomiko tregtare. Programet financiare parashikojnë aktivin dhe pasivin e veprimtarisë së firmes, të shprehura në valute të konvertueshme. Rezultatet financiare të veprimtarisë së firmes caktohen në bazë të bilancit vjetor.

K R E U IV

ADMINISTRIMI

NENI 16

Organi vendimor i firmes është Këshilli i Ortakëve. Në të marrin pjesë ortakët me të drejtë vote në raport me pjesën e kuotes së tyre në kapitalin e përgjithshëm.

Këshilli i Ortakëve vendos për bilancin vjetor, për ndryshimet në statut, për shtimin ose pakesimin e kapitalit bazë të firmes, për emerimin e komisionit të revizionit kontabel, si dhe për pushimin e veprimtarisë së firmes etj.

Unanimiteti në vendimet e Këshillit të Ortakëve është i nevojshëm për këto çështje:

- ndryshimet e statutit,
- miratimin e programit vjetor të veprimtarisë së firmes,
- zgjatja e kohës së veprimtarisë së firmes,
- pushimin e veprimtarisë së firmes.

Për çështje të tjera, Këshilli i Ortakëve vendos me shumicë votash. Këshilli i Ortakëve i merr vendimet e veta gjatë mbledhjeve të tij. Në rast të vecanta vendimet merren duke shprehur me shkrim mendimin e sejcilit votues, në përputhje me rregullat proceduriale të vendosura nga Këshilli i Ortakëve. Çdo anëtar i Këshillit të Ortakëve ka një vote.

NENI 17

Keshilli i Ortakeve eshte kopetent per te marre vendime per cdo aspekt te veprimtarise se firmes.

- Gjate veprimtarise se firmes Keshilli i Ortakeve ka edhe keto kopetenca:
- miratimi i programeve dhe i llogarive ekonomike, pas perpunimit te tyre ne kuadrin e objektit te firmes, sipas nenit 3,
 - percaktimin e regjimit dhe kushteve te zbatimit te parimeve te llogarise ekonomike,
 - percaktimi i rregullave normative qe perkufizojne raportet ne gjirin e ortakterise, duke perfshire edhe kuadrin e personelin,
 - percaktimi i struktures se aparatit te firmes,
 - percaktimi i organikes dhe ndarja e vendeve drejtuese ndermjet perfaqesuesve te ortakeve,
 - emertimi dhe zevendesimi i Drejtorit te Pergjithshem,
 - krijimi i organeve te tjera te domosdoshme per realizimin e objektivave dhe funksioneve te firmes,
 - percaktimi i madhesise se kuotave minimale per cdo ortak per formimin e kapitalit baze te firmes,
 - paraqitjen e propozimeve asamblese se Ortakeve per rregullimin , krijimin dhe perfitimin nga fondet e vecanta, ndarjes se fitimeve si dhe percaktimin e rregullave per shlyerjen e borxheve,
 - marrjen e vendimit per krijimin e filialeve, te degeve e te perfaqesive, si dhe per cedimin e veprimtarise se tyre,
 - perzgjedhjen e anetareve te komisionit te likuidimit, te cilet emerohen dhe revokohen nga asambleja e ortakeve,
 - kryerjen e veprimtarive per likuidimin e llogarive qe u perkasin ortakeve doreheqes se firmes,
 - marrjen e vendimit per kerkimin dhe perdorimin e kredive afatgjate.

Kryetari i Keshillit Drejtues emerohet, sipas rradhes, sejcili nga anetaret e ketij keshilli per nje kohe, jo me shume se 3 vjet. Ai ka per detyre:

- te siguroje drejtimin e firmes,
- te perfaqesoje firmen ne lidhje me te tretet, brenda caqeve te objektit te veprimtarise se saj, pervec ceshtjeve qe kerkojne unanimitetin e ortakeve ose qe kane te bejne me kopetencat qe ky statut ia atribuon Keshillit Drejtues,
- te mbledhe Keshillin Drejtues,
- te siguroje zbatimin sakte te vendimeve te Keshillit te Ortakeve.

NENI 18

Veprimtaria operative e firmes administrohet nga Drejtori i Pergjithshem i saj. Deri ne rritjen e aktivitetit te plote te firmes kete detyre do ta kryeje Kryetari (Presidenti) i Keshillit te Ortakeve.

Organi ekzekutiv e firmes merret me keto ceshtje:

- Organizon punen per realizimin e programeve te firmes dhe raporton per to,
- ne perputhje me programet e me planet e pergjitheshme administron pasurine e firmes, duke perfshire ketu mjete financiare brenda caqeve te vendimeve te marra nga organi administrativ i firmes,
- drejton e kontrollon veprimtarine e filialeve, te degeve e perfaqesive,
- perfaqeson firmen perpara te treteve ne Gjykata e ne Arbitrazhe, nenshkruan kontrata ne emer e per llogari te firmes dhe siguron venjen e tyre ne rrjete,
- merr te gjitha vendimet qe kane lidhje me ato veprimtari te firmes qe nuk jane ne kopetence ekskluzive te Keshillit te Ortakeve,
- raporton dhe pergjigjet para Keshillit te Ortakeve per zbatimin e veprimtarise te firmes, si dhe per realizimin e objektivave e te detyrave

NENI 19

Maredhenjet e punes ne firme, ne filiale, ne dege ose ne perfaqesite rregullohen nepermjet kontrates se punes.

Per ceshtjet qe nuk rregullohen ne kontraten e punes, zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar te punes.

K R E U V

NENI 20

Veprimtaria e firmes pushon me 31.12.2000 ose me pare sipas propozimit te bere nga njeri prej ortakeve, kur gjate dy vjeteve nuk rezulton rentabel, ose kur te gjitha ortaket me perjashtim te njerit, heqin dore nga firma, si dhe ne te gjitha rastet qe parashikohen ne dokumentin e krijimit te firmes (kontrate).

Firma shperndahet ne forme riorganizimi ose likuidimi.

NENI 21

Kur firma riorganizohet behet rigrupimi i fondeve dhe eventualisht likuidimi i anetareve qe largohen.

Kur firma likuidohet plotesisht:

- Keshilli i Ortakeve emeron Komisionin e Likuidimit, te cilit i paraqet bilancin e likuidimit dhe firma i jep fund veprimtarise se saj, ne castin e miratimit te ketij bilanci.
- mjetet financiare, te fituara si rezultat i veprimtarise se firmes e te filialeve te saj, dhe fondet financiare ndahen ndermjet ortakeve, pasi te jene bere pagesat per kreditoret.

NENI 23

Kur pushon veprimtaria e firmes, per efekt riorganizimi te saj, afatet e pushimit caktohen nga Keshilli i Ortakeve. Likuidimi i filialeve behet njelloj si edhe per firmen.

Petrit Mersini

Natasha Moleni

Luan Shahu

Pandi Carapuli

Robert Kasneci